



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr. 1244 Prot.

Tiranë, më 04.02.2021

UDHËZIM

Nr. 6, datë 04 2.2021

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1 DATË 8.1.2021 "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË SKEMËS SË MBËSHTETJES ME NAFTË PËR BUJQËSINË"**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 137/2021, "Për buxhetin e vitit 2021", të pikës 16, të Vendimit nr. 1142, datë 24.12.2020, "Për përcaktimin e kriterëve bazë, masës së përfitimit dhe mënyrës së përdorimit të fondit për skemën e mbështetjes me naftë për bujqësinë, për vitin 2021",

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1 datë 8.1.2021 "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë" bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, pika 9, pas fjalisë së parë, shtohet fjalia e dytë me formulimin:  
"Nëse dokumentacioni i pronësisë së tokës i ngarkuar në sistem nga aplikanti është fotokopje ose i paplotë, do të konsiderohet i vlefshëm nëse gjatë kontrollit administrativ konfirmohet me vërtetimin "pozitiv" nga ASHK".
2. Në kreun IV, pika 10, në fund të tabelës, shtohen nënpikat e mëposhtme:  
10/1. Kontratat e vlefshme të qirarmarrjes, të cilat duhet të përfshijnë edhe vitin 2021, të lidhura me ish Drejtoritë e Bujqësisë, MBZHR ose komunat/bashkitë, kanë të njëjtën vlerë me ato të bëra pranë noterit publik dhe nuk kërkohen të jenë të noterizuara.  
10/2. Kur gjatë kontrollit administrativ të dokumentacionit, sipërfaqet e parcelave sipas AMTP rezultojnë me diferenca me ato sipas ASHK-së, merren në konsideratë të dhënat e ASHK.

10/3. Marrëveshje dakordësie kërkohet edhe në rastet kur aplikanti është njëri prej bashkëpronarëve sipas certifikatës së pronësisë së tokës bujqësore. Modeli tip i marrëveshjes së dakordësisë jepet në aneksin 8, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

10.4 Kur certifikata e pronësisë së tokës bujqësore është në pronësi të personit/personave të ndryshëm nga aplikanti, kërkohet kontratë qiraje/huapërdorjeje e noterizuar, pavarësisht se aplikanti mund të jetë anëtar i të njëjtës familje.

3. Në kreun V, bëhen ndryshimet e mëposhtëme.

-Pika 9, zëvendësohet me formulimin:

“9. Listat pjesore dhe lista përfundimtare e aplikimeve të miratuara si dhe lista përfundimtare e aplikimeve të skualifikuara nga AREB-et, i kalojnë MBZHR-së, e cila i akseson ose në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të naftës për bujqësinë ose në një formë tjetër elektronike.

Këto lista dërgohen zyrtarisht pranë MBZHR-së edhe në formë shkresore”.

-Pika 13, zëvendësohet me formulimin:

“13. Bazuar në listat e dërguara zyrtarisht nga AREB-et, Njësia e Posaçme në MBZHR publikon në faqen zyrtare të internetit të ministrisë listat pjesore dhe listën përfundimtare të përfituesve me masën përkatëse të përlllogaritur të naftës për subjektet përfitues.

Listat publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit të AZHBR-së”.

-Në pikën 5, në shkronjën “c”, në fund të fjalisë së dytë, shtohet togfjalëshi “...dhe e konfirmuar me vërtetimin “pozitiv/negativ nga ASHK”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

